Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0532

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092), si dhe nenit 21 dhe 29 te Rregullores se Punës se OSHP-se 01/2020, e amandamentuar me 09. 08. 2023, në përbërjen nga Agon Ramadani - Kryetar, Vjosa Gradinaj - Mexhuani dhe Vedat Poterqoi - Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së OE "Inovix" SH.P.K., kundër Njoftimit te kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Badimetria (Matja e volumit te ujit), analiza e sendimenteve per 6 Digat" me numër të prokurimit 210-23-4683-2-1-1, te Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor ne cilësi te autoritetit kontraktues (AK), më 17/10/2023, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet** si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Inovix" SH.P.K, e dates 31.07.2023, me numër te protokollit 2023/0532, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Badimetria (Matja e volumit te ujit), analiza e sendimenteve per 6 Digat", me numër të prokurimit 210-23-4683-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor.

2. **Anulohet** aktiviteti i sipër cituar, ndërkaq nëse AK edhe më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ri tenderoj.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mosrespektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë.

4. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor (MMPH) në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 12.05.2023 ka paraqitur Njoftimin për kontratë - B05, për aktivitetin e prokurimit me titull "Badimetria (Matja e volumit te ujit), analiza e sendimenteve per 6 Digat" me numër te prokurimit 210-23-4683-2-1-1.

Me 18.07.2023, OE "Inovix sh.p.k" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Ndërsa me 20.07.2023, AK– MMPH, ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik ankues si të pabazuar.

Operatori ekonomik "Inovix sh.p.k" i pakënaqur me Njoftimin për kontratë, me 31.07.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është regjistruar me numër protokolli 532/23.

- Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues konstatoi se ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotësonte kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nën paragrafin 75 të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 07.08.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet:

- Ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar,
- Të anulohet njoftimi për kontratë, të ri tenderohet aktiviteti nëse AK ka interes edhe me tej

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues ka njoftuar Panelin Shqyrtues se nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit ndërsa Operatori Ekonomik Ankues nuk është deklaruar.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe

konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

Përgjigjet e AK-së lidhur me pretendimet ankimore në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim

Se pari ju njoftojmë se kjo procedure e prokurimit nuk mund te anulohet për shkak te kërkesës tuaj e cila nuk është e bazuar dhe e argumentuar. Njëherit analizoni dosjen e tenderit se kriter për përzgjedhje nuk është vetëm oferta financiare por është edhe oferta teknike dhe secili pozicion e ka peshën e vet dhe është mjaft mire e precizuar dhe lehtësisht e matshme. Ne aneksin 6 te dosja e tenderit janë përcaktuar kriteret dhe nën kriteret me peshat dhe piket përkatëse gjë qe e bene shume te lehte vlerësimin e tyre ne baze te pikëve pasi qe janë te matshme. Andaj bazuar ne përgjigjet e dhëna nga ana e AK ju njoftojmë se kërkesa juaj refuzohet si e pa baze.

Pretendimet e Ankuesit "Inovix" SHPK

- *Pretendimi i parë (I)*- Autoriteti Kontraktues pasi qe Nuk ka respektuar Pezullimin e procedurës sipas Rregullores 001/2022 Neni 61 Paragrafi 1,duke bere një shkelje substanciale te dispozitave te LPP-se nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, atëherë pretendimet ankimore te parashtruara ne kërkesën për rishqyrtim tani me janë te rendit te dyte te paraqitura dhe ne ankese. Kërkojmë nga eksperti shqyrtues i OSHP-se te trajtoj si pretendim ankimor piken e pare te ankesës sepse është shkelje serioze nga ZPP.
- *Pretendimi i dytë (II)*- Ne ketë dosje përveç shkeljes se pare te kritereve te njëjta një shkelje substanciale janë kriteret e pa matshme dhe jo objektive, sepse nuk ka një prag minimal deri maksimal se si tenderuesit gjate fazës se ofertimit mund te arrijnë piket pra nuk ka një tavan. Ne baze këtij formulimit përveç çmimit te ofruar qe OE mund te dijen piket e fituara ne baze te procesverbalit te hapjes te gjitha nen kriteret e dhënies se kontratës janë pa matshme ne tërësi dhe diskriminuese për secilin OE sepse asnjë OE nuk mund te dije ne asnjë rast sa pike do i fitoj ne raport me tenderuesit tjerë. Kërkojmë nga Zyra e prokurimit qe shkeljet substancialë te LPP-se te cekura me larte dhe te cilat janë te pa përshtatshme për te përcaktuar tenderin ekonomikisht te favorshëm te veprohet sipas Nenit 27 Kriteret e Dhënies së Kontratës paragrafi 27.7 Kur bëhet dhënia e kontratës në bazë të kriterit "tenderi ekonomikisht më i favorshëm", dosja e tenderit dhe, nëse aplikohet, njoftimi për kontratë duhet të deklarojë të gjitha kriteret (në një mënyrë objektive dhe të matshme) që aplikohet në procesin e dhënies, dhënia e peshave relative (në kushte monetare) të përcaktuara për secilin kriter.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues për ankesën 532/23

- *Konstatimi i parë (I)*- AK Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor nuk e ka respektuar nenin 108A pasi kërkesa për rishqyrtim lidhur me kriteret qe është bere nga OE ankues "Inovix shpk" ka qene e bazuar dhe ne përputhje me nenin 108A. Ne baze te pretendimeve ankimore qe është bere ne kërkesën për rishqyrtim kriteret e dosjes se tenderit kriteret minimale për kualifikim (kriteret e përzgjedhjes) nuk përdorën si kritere në procesin e dhënies së kontratës ne këtë tender janë kritere te njëjta qe këto kritere vlerësohen si kritere kalon/nuk kalon. Duke u bazuar ne kritere te dhënies se kontratës te dosjes se tenderit nga AK-ja vetëm kriteri i metodologjisë mundet cilësohet si kriter për dhënien e kontratës dhe qe

nuk është i njëjtë me kriteret e përzgjedhjes. Ne baze te rregullores për prokurim publik neni 25 kriteret e përshtatshmërish dhe kërkesat minimale për kualifikim te gjitha këto konsiderohen si kritere te përzgjedhjes, kërkesa e përzgjedhjes janë kërkesa qe OE duhet ti plotësojnë për te konsideruar i kualifikuar dhe atëherë kur te behet vlerësimi i kritereve te përzgjedhjes OE qe konsiderohen te kualifikimit. Këto dokumente te kualifikimit, megjithatë, në mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese te OE qe dëshirojnë me konkurruar ne tender, AK duhet të përcaktoj në Dosje të Tenderit kriteret objektive dhe jo-diskriminuese. Ne këtë rast kur AK-ja shpall tender ne baze te kriterit "tenderi ekonomikisht më i favorshëm", duhet te jenë të gjitha kriteret në një mënyrë objektive dhe të matshme dhe nuk duhet te jen te njëjta me kriteret e përzgjedhjes, kriteret që aplikohet për dhënie, dhënia e peshave të përcaktuara për secilin kriter duhet te jete e matshme ato duhet të vendosen ne dosjen e tenderit dhe të bëhen të ditura për tenderuesit. Ne baze te rregullores për prokurim publik kur përzihen/përsëriten kriteret për dhënie dhe kriteret e përzgjedhjes ose nuk janë caktuar kriteret mire si kritere te matshme atëherë procedura e prokurimit duhet te anulohet.

- *Konstatimi i dytë (II)*- Kriteret nuk kane qene te përcaktuar mire ne dosjen e tenderit sipas ligjit te prokurimit dhe sipas rregullores dhe Udhëzuesit. Se pari ne baze te ligjit te prokurimit nuk duhet te përzihen kriteret nga AK-ja po e citojmë nenin: 4. Autoriteti kontraktues duhet të sigurojë që të bëje një dallim të qartë në mes kritereve të paragrafit 3. të këtij neni dhe kritereve të përzgjedhjes në lidhje me aftësitë e përgjithshme profesionale, financiare dhe teknike të themeluara në bazë të nenit 51 të këtij ligji dhe se nuk ka përsëritje të këtyre dy kategorive të kritereve. 3. Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kritere të tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistenca teknike. Ndërsa ne baze te rregullores për Prokurim publik nenit 27.3 po e citojmë: 27.3 Nëse kriteri është 'tenderi ekonomikisht më i favorshëm', kontrata duhet ti jepet tenderit i cili më së miri përmbushë kriteret relevante. Përveç çmimit AK mund të përfshijë kritere tjera relevante për lëndën e kontratës, siç janë:

a. Karakteristikat e cilësisë
b. Kostot Operative, të mirëmbajtjes dhe kosto tjera të jetë-gjatësisë
c. Karakteristika funksionale, teknike, mjedisore, estetike ose të ngjashme
d. Shërbimi i pas-shitjes dhe asistencës teknike

27.4 Kriteret duhet të përcaktohen me peshë sipas rëndësisë relative. Nëse e shikon nenin 52 te Ligjit qe i kam cituar me lart dhe neni 27 te Rregullores tregon qarte se kriteret nuk duhet te jene te njëjta për vlerësim nëse tenderi është ekonomikisht me i favorshëm shikoni qysh i parasheh ligji dhe rregullorja përveç çmimit duhet te jene cilësia, mirëmbajtja karakteristikat funksionale, teknike e tjera. Gjithashtu sipas ekspertit shqyrtues kriteret duhet te pasqyroj tregun matshëm ne rajone sa i përmbushin edhe OE kriteret e dhënies pra mos te behet diskriminim dhe te jen te lidhura me natyrën e lendes se kontratës. Kriteret duhet të shprehen me peshat dhe formulën e përdorur për dhënien e pikëve në mënyrë të qartë dhe të saktë, në mënyrë që tu mundësohet OE-ve të dorëzojë oferta duke pasur njohuri të sakta për nevojat e AK-së dhe rregullat që duhet të zbatohen për vlerësimin e një tenderi. Vetëm në këtë mënyrë garantohet parimi i trajtimit të barabartë dhe transparencës së plotë. Sa i përket këtij pretendimi disa gjera janë te sqaruar edhe ne përgjigjeje ne pretendimin 1 dhe ky pretendim është i bazuar.

- Përgjigje ne pretendim e nenit 7

Shkelje e Nenit 7, Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi. Autoriteti kontraktues me rastin e shpalljes se Njoftimit për kontrate dhe dosjes se tenderit ka vendosur kritere diskriminuese, duke u bazuar ne këto te cekura me larte mendojmë se kriteret janë kërkuar ne maksimumin e mundshëm dhe kjo shifet se është bere kufizim i konkurrencës e nuk duhet te neglizhuar kriterin e dosjes se tenderit qe te përgatiten kritere sa me profesional për te ushtruar veprimtarinë profesionale për ofrimin e shërbimeve te natyrës se njëjtë si qe ka kërkuar AK. *Info për panelin e OSHP-se.* Kriteri ekonomiko financiar është kërkuar me shume se qe kërkohet me Ligjin e prokurimit publik te Kosovës pasi është kërkuar me shume se 1.5 here. Buxheti është 950.000.00 €, Qarkullim është kërkuar 1,920.000.00 €, 1.5 here i bien me kane buxheti 1,425.000.00 €. Shikoni qysh është me Ligj citat: Në përcaktimin e qarkullimit minimal, autoritetet kontraktuese nuk duhet të kalojnë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës. Kërkesa për qarkullim duhet të shprehet detyrimisht në shifra dhe duhet ti referohet maksimum tri viteve të fundit financiare. Vitet e tilla financiare duhet të përcaktohen qartë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për tender ose pjesëmarrje. Kur, përveç qarkullimit minimal, një qarkullim i caktuar minimal në fushat specifike të mbuluara nga kontrata është i nevojshëm, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë 1.5 herë vlerën e parashikuar të kontratës. Ne baze te kësaj eksperti shqyrtues mendon se AK-ja ka tejkaluar limitet e përcaktuar me ligj dhe rregullore dhe duhet te anulohet aktivitetit i prokurimit pasi probabiliteti i përshtatjes se kritereve dhe buxheti mundet te konsiderohet i madh për përshtatje te kritereve nga AK-ja.

Konstatimet dhe vlerësimet e Panelit Shqyrtues.

Me qellim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, Paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e Operatorit Ekonomik ankues dhe Autoritetit Kontraktues, dhe gjeti se ankesa e parashtruar nga OE "Inovix" SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar, është e bazuar.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të anulohet sepse, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Paneli Shqyrtues konsideron se rrjedha e aktivitetit të prokurimit, nuk karakterizohet në përputhje me dispozitat ligjore, të cilat në raport me qëllimin e synuar të këtij aktiviteti të prokurimit, nga pikëpamja e këtij Paneli, janë implementuar me kujdesin e shtuar dhe në mënyrë profesionale.

Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, paneli shqyrtues ne vlerësimin e tij të pavarur konsideron AK nuk ka respektuar legjislacionin në fuqi të referuar sepse kriteret minimale për kualifikim (kriteret e përzgjedhjes) nuk përdorën si kritere në procesin e dhënies së kontratës ne këtë tender janë kritere te njëjta qe këto kritere vlerësohen si kritere kalon/nuk kalon, andaj paneli lidhur me përsëritjen e kriterit vlerëson se duke u bazuar ne kritere te dhënies se kontratës te dosjes se tenderit nga AK-ja vetëm kriteri i metodologjisë mundet cilësohet si kriter për dhënien e kontratës dhe qe nuk është i njëjtë me kriteret e përzgjedhjes, poashtu nën-kriteret e përpiluara në aspektin e vlerësimit nuk janë të qarta, për faktin se të njejtat poashtu janë

të pa matshme dhe jo objektive, sepse nuk është evidentuar një prag minimal deri maksimal se si tenderuesit gjate fazës se ofertimit mund te arrijnë piket.

Paneli shqyrtues vlerëson se të gjitha kriteret duhet te jenë në mënyrë objektive dhe të matshme dhe nuk duhet te jenë te njëjta me kriteret e përzgjedhjes, kriteret që aplikohet për dhënie, dhënia e peshave të përcaktuara për secilin kriter duhet te jete e matshme ato duhet të vendosen ne dosjen e tenderit dhe të bëhen të ditura për tenderuesit, kjo specifikohet qartë sipas nenit 52, paragrafi 4 :*" Autoriteti kontraktues duhet të sigurojë që të bëje një dallim të qartë në mes kritereve të paragrafit 3. të këtij neni dhe kritereve të përzgjedhjes në lidhje me aftësitë e përgjithshme profesionale, financiare dhe teknike të themeluara në bazë të nenit 51 të këtij ligji dhe se* ***nuk ka përsëritje të këtyre dy kategorive të kritereve."***

Në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit kriteret nuk kane qene te përcaktuar konform LPP-së dhe sipas rregullores dhe Udhëzuesit pasi që të njëjtat nuk duhet te përsëriten nga AK-ja ashtu siç është paraparë në nenin dispozitën e referuar si më sipër e poashtu me nenin 27 të Rregullores për Prokurim Publik.

Arsyeja tjetër përcaktuese që ka orientuar drejt vendimarrjes sikurse në dispozitiv të këtij vendimi ka qenë çështja e evidentuar nga paneli sa i përket kritertit të Qarkullimit financiar - xhiroja totale për periudhën e shkuar tre vjeçare në të cilin është kërkuar që vlera duhet të jetë jo më pak se 1,920,000.00 €, ndërsa vlera e parashikuar e këtij aktiviteti ka qenë 950.000.00 €, lidhur me këtë çështje neni 68, paragrafi 1 përcakton qartë që: "*Kur kërkohet, qarkullim minimal vjetor që operatorët ekonomik duhet të kenë* ***nuk do të kalojë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës.",*** që në rastin konkret konform kësaj dispozite i bie që AK ka mundur që si kërkesë mbi qarkullimin financiar të përcaktojë vlerën deri në 1,900,000.00 €, kështu që rrjedhimisht vlera e përcaktuar prej 1,920,000.00 € tejkalon limit e lejuar sipas ligjit, konkretisht dispozitës të referuar si më lartë.

Andaj duke u bazuar nga arsyet e dhëna si më sipër, paneli ka arritur në konstatimin përfundimtar se DT nuk është përpiluar konform legjislacionit në fuqi, andaj duke qenë se kriteret në këtë fazë (pas dorëzimit të ofertave) nuk mund të përmirësohen, zgjidhja e vetme është që aktiviteti të anulohet në tërësi, ndërsa në rast të ritenderimit, AK të ketë kujdes të shtuar në hartimin e kritereve sipas legjislacionit në fuqi, duke u bazuar në kërkesat, nevojat si dhe planifikimet e tyre.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se vendimi i AK-së duhet të anulohet dhe nëse AK edhe më tej ka interes për të vazhduar me këtë procedurë të prokurimit, të njëjtin ta ritenderoj.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I dhe II dhe III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor**
- OE - **" Inovix " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: